



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në bazë të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, neni 6 paragrafi 6.3 bie këtë:

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik Visar Kuçi B.I.; N.N.SH. TOP PROJEKT ; N.N.T. Shabanaj e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 01.11.2020 për aktivitetin e prokurimit me numër 626-20-5348-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-20-026-5-2-1 me titull “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në Mamushë-Faza e parë, ndërtimi i vrazhdët”

II

Vërtetohet vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës i datës 27.10.2020 me të cilin është shpërblyer me kontratë Grupi i operatorëve ekonomik AAB CONSTRUCTION " SH.P.K. N.P.SH “BAGERI” & “AL-GROUP” SH.P.K. – Prishtinë

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik Visar Kuçi B.I.; N.N.SH. TOP PROJEKT ; N.N.T. Shabanaj me datë 01.11.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në Mamushë-Faza e parë, ndërtimi i vrazhdët”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e grupit të O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1, 6, 7, 59, 69 dhe 72 të LPP-s. Të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s janë të pa baza.

Sikur kemi cekur në njoftimin B58 për vendimin e Autoritetit Kontraktues, grupi i O.E. ankues, nuk i ka përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale, pasi që në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek seksioni II Fleta e të dhënave të tenderit në nenin 9.1& 9.2 në pikën 2 është paraqitur kushti si vijon: 2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, minimumi 10 punëtor të rregullt ose me parakontratë nga të cilët minimumi 2.1-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë ose Bachelor me master të përfunduar-Drejtimi konstruktiv –

Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 5 vite përvojë pune – në angazhimet profesionale. 2.2-Një (1) Inxhinier i Dip. i ndërtimtarisë ose Bachelor me master të përfunduar-Drejtimi hidroteknik – Kërkohet që inxhinieri të ketë min. 5 vite Një dhe 2.3 Një(1) Inxhinier i Dip. i gjeodezisë me licenc-min. 3 vite përvojë pune pas diplomimit në angazhimet profesionale.

Si dëshmi për këtë kërkesë është kërkuar që të paraqiten dokumentet si në vijim:

2. Lista e stafit të punëtorëve dhe inxhinierëve të O.E. origjinal e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. -Diplomat e inxhinierëve (kopje e noterizuar), -CV-të e inxhinierëve të nënshkruar nga inxhinieri (origjinal ose kopje e noterizuar) Për gjeodetën-Kopja e noterizuar e licencës.

Grupi i O.E. ankues, ka dorëzuar listën e stafit dhe diplomat e inxhinierëve të kërkuar, mirëpo asnjëra nga CV-të e paraqitura, nuk janë nënshkruar nga vetë inxhinierët sikur është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë. Andaj me të drejtë komisioni i vlerësimit, ka konstatuar se Grupi i O.E. ankues nuk i ka plotësuar kërkesat në fjalë pasi që në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, në paraqitjen tabelore, është paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Edhe pretendimi se nuk është zbatuar neni 72 i LPP-s dokumentacioni dhe informacioni shtesë, ndërsa për kompanitë tjera keni kërkuar sqarim shtesë për ne jo dhe pretendimi se grupi ankues është diskriminuar nga AK apo komisioni vlerësues është i pa bazuar.

Në dispozitat e nenit 72 në paragrafin 3 shprehimisht është paraparë që Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Pasi që dokumenti i kërkuar ka qenë CV e cila nuk është dokument ekzistenca e të cilit është e fiksuar, ne si AK nuk kemi kërkuar sqarim. Për më tepër në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, në paraqitjen tabelore është paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Pretendimi i grupit ankues se në nenin 86 të RROUP-s thotë: CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos, mund të kërkohej informata sqaruese është i gabuar. Në RROUP nuk ka nen 86. Nga pjesa e kopjuar e RROUP-s të cilën e ka paraqitur grupi i O.E. ankues shihet se është fjala për nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, në paraqitjen tabelore. Në këtë dispozitë, shprehimisht është cekur se në rast se CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos, mund të kërkohej informatat sqaruese. Mirëpo grupi i O.E. ankues i ka dorëzuar CV-të me informatat e kërkuara, por kërkesa ka qenë që CV-ja të nënshkruhet nga vetë inxhinierët dhe për këtë rast RROUP kanë paraparë që nëse CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Edhe pretendimi se është shkelur neni 7 i LPP-s Barazia në trajtim/jo-diskriminimi, pasi që për O.E. të eliminuar keni kërkuar sqarime shtesë në çmimet e ofruara në pozicione të paramanës për çmimet jo normalisht të ulëta, nuk i është përgjigjur brenda afatit kohor të caktuar nga AK si dhe për O.E. fitues AAB Construction SH.P.K. nuk është kërkuar sqarim shtesë në pozicionet e ofruar të paramasës pothuajse të gjitha pozicionet janë të njëjta me çmime jo normalisht të ulët sikurse O.E. i eliminuar për këto pozicione ku ka pozicione edhe me çmime të njëjta si dhe ka çmime edhe më të ulëta O.E. fitues se O.E. i eliminuar, është i pa bazë.

Ne me datën 20.10.2020, përmes dokumentit B41 letër standarde për sqarimin e tenderit jo-normalisht të ulët, kemi kërkuar nga Grupi i operatorëve ekonomik AAB CONSTRUCTION " SH.P.K. N.P.SH "BAGERI" & "AL-GROUP" SH.P.K. sqarimin e njëjtë sikur kemi kërkuar edhe për Intact SH.P.K. por për dallim nga ky i fundit grupi i O.E. i cili është shpërblyer me kontratë na ka ofruar sqarimi e kërkuar.

Më tutje Grupi i O.E. ankues e ngatërron formularin e paraqitjes së tenderit me para-masën apo përshkrimin e çmimit. Sa i përket formularit të tenderit në nenin 33 pika 33.18 është paraparë që në rast të dorëzimit të tenderit në formë elektronike, nënshkrimi digjital i avancuar nuk është i obligueshëm deri ne njoftim zyrtar nga KRPP. Gjithashtu edhe sa i përket përshkrimit të çmimit, në nenin 39.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, ne paraqitjen tabelore, është paraparë vetëm për ofertat fizike nëse nuk janë nënshkruar, të refuzohet tenderit pa kërkuar informacione shtesë, mirëpo o.e. i rekomanduar për kontratë, tenderin e ka dorëzuar në formë elektronike përmes e-prokurimit. Pra edhe sikur u shpjegua më lartë, edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit se O.E. i rekomanduar si fitues ka ofruar planin dinamik por jo sikur është tek kërkesa e Dosje së tenderit sepse ka ofruar plan dinamik me data ku data e fillimit të punimeve është cekur 02.10.2020 vendimi i shpallur fitues data 27.10.2020 edhe ky pretendim nuk qëndron pasi që ne kemi kërkuar që plani dinamik të hartohet në ditë pune i cili nuk duhet të jetë më i gjatë se 45 ditë pune. Grupi i O.E. i rekomanduar ka dorëzuar planin dinamik për 45 ditë pune por e ka kalkuluar datën që nga data e dorëzimit. Sipas LPP-s autoriteti kontraktues duhet ta kryej vlerësimin e tenderit brenda afatit prej 30 ditëve, andaj nuk mund të parashikohet data se kur do të fillojnë punimet pa u përfunduar procedura e prokurimit. Pra edhe ky pretendim është i pa bazë.

Sa i përket pretendimit se O.E. i rekomanduar si fitues nga AK ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta, kemi sqaruar më lartë se ne kemi kërkuar sqarim nga ky i fundit për çmimin jo normalisht të ulët dhe kemi marr përgjigje dhe tenderi i tyre është trajtuar në mënyrë të barabartë me tenderët tjerë.

Sa i përket dëmeve materiale, në dosje të tenderit është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. Andaj edhe ky pretendim është i pa bazë.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 09.11.2020

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushës

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.